



## Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” Prishtinë

Universiteti i Prishtinës pjesë e Aleancës Universitare dhe  
e Zonës Evropiane të Dijes

Programi i punës i kandidimit për pozitën e Rektorit në  
Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”

Kandidati: But Dedaj

Prishtinë, Qershor 2024

## **Përmbajtja**

<b>1. Hyrje .....</b>	<b>3</b>
<b>2. Gjendja aktuale në UP .....</b>	<b>3</b>
<b>2.1. Analiza SWOT.....</b>	<b>4</b>
<b>3. Fushat e punës për mandatin menaxhues.....</b>	<b>6</b>
<b>3.1. Programet studimore .....</b>	<b>7</b>
<b>3.2. Mësimdhënia dhe studentët .....</b>	<b>9</b>
<b>3.3. Modelet e financimit .....</b>	<b>11</b>
<b>3.4. Sigurimi i cilësisë .....</b>	<b>13</b>
<b>3.5. Veprimtaria kërkimore shkencore/artistike dhe infrastruktura .....</b>	<b>14</b>
<b>3.6. Ndërkombëtarizimi.....</b>	<b>16</b>
<b>3.7. Bashkëpunimi me ekonomi dhe shoqëri - Misioni i Tretë.....</b>	<b>17</b>
<b>3.8. Menaxhimi dhe koordinimi.....</b>	<b>18</b>
<b>4. Aneks: Të dhëna bazë të CV-së dhe disa prej projekteve të zbatuara.....</b>	<b>20</b>

## 1. Hyrje

Universiteti i Prishtinës (UP) është institucion i rëndësisë së veçantë për Republikën e Kosovës. Që nga themelimi në vitin 1970 (si institucioni i parë i arsimit të lartë në Kosovë), UP-ja ka qenë shtylla kryesore e zhvillimit social dhe ekonomik në vend. Pashmangshëm, ka qenë institucioni kryesor edhe në rrugën e shtetndërtimit të Republikës së Kosovës. Duke u bazuar në rëndësinë dhe potencialin që ka, janë realiste pritjet që edhe në të ardhmen UP të jetë institucioni kryesor, që do të kontribuojë në rrugën e realizimit të aspiratave të Kosovës që të jetë në grupin e shteteve ekonomisht të zhvilluara dhe pjesë e komunitetit euroatlantik.

Vizioni dhe misioni i UP-së janë të qartësuara në Statut dhe dokumente të tjera të rëndësisë së veçantë, duke reflektuar përkushtimin për zhvillimin akademik, dhe veprimtarinë kërkimore-shkencore/artistike të standardeve më të larta, duke u përcaktuar si në vijim:<sup>1</sup>

*“Vizioni: Universiteti i Prishtinës është një institucion i arsimit të lartë, i njohur globalisht për profesionalizëm, integritet, mësimdhënie cilësore dhe hulumtim. Në harmonizim me nevojat e ekonomisë dhe të tregut, do të vendosë dhe mirëmbajë standarde të cilësisë, duke përkrahur mobilitetin dhe zhvillimin e karrierave akademike për personelin dhe studentët, duke e rritur numrin e partnerëve dhe duke iu bashkuar rrjetit të edukimit të lartë evropian.*

*Mision: Misioni i UP-së bazohet në zhvillimin akademik, hulumtimet shkencore, artistike dhe sigurimin e arsimit të lartë përmes programeve me interes strategjik dhe zhvillimor të Republikës së Kosovës. Universiteti mundëson mobilitetin e programeve, studentëve dhe stafit akademik në vazhdimësi, me qëllim të arritjes së nivelit ndërkombëtar dhe konkurrencës në treg.”*

## 2. Gjendja aktuale në UP

Përkundër autoritetit që gëzon në Kosovë, rëndësisë së veçantë për shoqëri, kapaciteteve njerëzore që i ka, studentëve që mbi performojnë, për një kohë të gjatë janë evidencuar dhe raportuar probleme të shumta, e në mesin e tyre edhe probleme që nuk do të duhej fare të ishin të pranishme në këtë etapë të zhvillimeve në arsimin e lartë, ose të paktën jo në përmasat që janë evidencuar.

Derisa këto zhvillime e karakterizojnë aktualitetin tonë, shumica e Universiteteve brenda Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë kanë vendosur si objektiva parësore ato aktivitete që shkojnë në drejtimin për të qenë pjesë e ndonjë Aleance Universitare, me synime të qarta për harmonizimin e programeve të studimit, për rritjen e shkëmbimit akademik, për njohjen reciproke të titujve e gradave shkencore, si dhe për krijimin e grupeve të mëdha të ekspertëve. Këto prioritete të përcaktuara dhe angazhime të Universiteteve brenda Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë (dhe jo vetëm) janë përgjigje ndaj nevojave të tregut të punës, ndërsa UP nuk është në hap me këto zhvillime.

<sup>1</sup> <https://uni-pr.edu/page.aspx?id=1,47>

Për shumë vite me radhë, janë shfaqur dhe akumuluar shumë probleme në UP. Disa nga më kryesoret mund të përmblihen në:

1. Probleme me zhvillimin dhe akreditimin e programeve, në veçanti në nivelin e tretë të studimeve, në ato të doktoratës (PhD);
2. Rënie në numrin e studentëve;
3. Probleme me përmbylljen me sukses të konkurseve për emërim, për riemërim ose për avancim të stafit akademik;
4. Probleme në menaxhimin e financave, me theks në zbatimin e rekomandimeve të auditorit;
5. Paqëndrueshmëri të menaxhmentit;
6. Mungesë e stafit të administratës, në mosrealizim të punësimit të personelit administrativ (edhe pse vendet e punës parashihen në buxhet);
7. Mbështetje e pamjaftueshme për veprimtarinë kërkimore-shkencor/artistike;
8. Ndërkombëtarizimi në letër por pa orientim të qartë;
9. Kornizë statutare dhe rregullative e mangët ose joadekuate;
10. Zbatim joadekuat i rolit të kompetencave të autoriteteve qeverisëse; Këshillit Drejtues, Rektorit dhe Senatit;
11. Bashkëpunim i pamjaftueshëm me ekonominë, ngecje në realizimin e “Misionit të Tretë” të Universitetit;
12. Vështirësi dhe ngecje në funksionalizimin e instituteve shkencore hulumtuese nëpër njësi akademike (NjA);
13. Imazh i dëmtuar i UP-së edhe si rrjedhojë e vlerësimeve dhe konstatimeve nga individë jokompetentë dhe me gjasë me agjenda të përcaktuara më parë.

Për t’i trajtuar dhe zgjidhur të gjitha këto probleme të specifikuar më lart, por edhe të tjerat që mund të dalin, kërkohet një angazhim i përbashkët dhe koordinim në mes të trupave qeverisëse brenda UP-së, por edhe faktorëve të tjerë relevantë, në rend të parë bashkëpunimi dhe koordinimi përmbajtjesor i UP-së me Ministrinë e Arsimit, të Shkencës, të Teknologjisë dhe të Inovacionit (MASHTI). Duhet angazhim dhe koordinim për të stabilizuar gjendjen ekzistuese, e në të njëjtën kohë për të trasuar rrugën e përparimit të UP-së, rrugë që ndjekin universitetet e vendeve të zhvilluara perëndimore në pajtim me Procesin e Bolonjës dhe me kërkesat e tregut të punës në nivel lokal dhe ndërkombëtar.

## **2.1. Analiza SWOT**

Për të pasur një pasqyrë më të mirë për gjendjen ekzistuese dhe aktivitetet që do të mund të ndërmerren për realizimin e objektivave të synuara, është përdorur analiza SWOT.

### Anët e forta të UP-së (Strength):

- UP-ja është institucioni më i vjetër dhe me më përvojë i arsimit të lartë në Kosovë;
- Institucion emblematic dhe i rëndësishëm së veçantë për shtetndërtimin dhe zhvillimin shoqëror e ekonomik të Kosovës;
- Traditë në tejkalimin e vështirësive dhe për punë në rrethana të jashtëzakonshme;
- Stafi akademik me përvojë, një pjesë prej tyre me grada shkencore të fituara në vendet e zhvilluara perëndimore dhe që mund të ligjërojnë në gjuhë të huaja;
- Përvojë në bashkëpunim me institucionet qeveritare dhe ekonominë;
- Përvojë bashkëpunimi me universitetet perëndimore;
- Diversitet i programeve studimore;

- Administratë me përvojë në arsimin e lartë;
- Përvojë në zhvillimin dhe akreditimin e programeve studimore;
- Traditë pjesëmarrjeje në projekte kërkimore-shkencore/artistike, lokale dhe ndërkombëtare;
- Lokacion i përshtatshëm dhe lehtë i arritshëm për tërheqjen e studentëve të regjionit dhe edhe më gjerë;
- Përvojë për punë ekipore dhe për realizimin e publikimeve kërkimore-shkencore/artistike në revistat me cilësi të lartë ndërkombëtare;
- Përvojë në realizimin e mobiliteteve akademike;
- Traditë në organizmin e konferencave, të seminareve dhe të punëtorive të ndryshme.

#### Anët e dobëta të UP-së (Weaknesses):

Disa nga anët e dobëta të prezantuara në pjesën hyrëse e që kanë të bëjnë edhe më shkaqet e problemeve prezente në UP, në vazhdim janë prezantuar si të grupuara:

- Kornizë rregullative e mangët ose joadekuate;
- Promovim i pamjaftueshëm për tërheqjen e studentëve të rinj;
- Hartimi dhe akreditimi/riakreditimi i programeve jo në masë të mjaftueshme në harmoni me kërkesat e tregut të punës dhe në adaptim të vazhdueshëm të mësimdhënësve ndaj këtij tregu;
- Rënie në numër e programeve të doktoratës;
- Sistem joadekuat të vlerësimit të performancës së stafit;
- Përshtatje e rregulloreve për nevoja konkrete të konkursit, e jo kritere të qëndrueshme afatgjata e transparente për emërim, për riemërim ose për avancim të stafit akademik,
- Kontratat e punës të stafit akademik të pa përkufizuara qartë;
- Kompetenca simbolike për udhëheqësit e NJA (dekanët);
- Mundësi e pashfrytëzuar për decentralizim të menaxhimit të financave;
- Financim pothuajse njëburimor (vetëm nga buxheti i Kosovës);
- Ndërrime të shpeshta të menaxhmentit pa e përfunduar mandatin e rregullt;
- Mbështetje e pamjaftueshme për veprimtarinë shkencore hulumtuese/artistike;
- Ndërkombëtarizimi në letër dhe pa orientim të qartë;
- Zbatim joadekuat i rolit dhe kompetencave të autoriteteve qeverisëse; Këshillit Drejtues, Rektorit dhe Senatit;
- Bashkëpunim i pamjaftueshëm me ekonominë;
- Institutet shkencore hulumtuese nëpër NJA jofunksionale;
- Angazhimet me mbinorma për stafin akademik;
- Promovim i pamjaftueshëm për zhvillimin e programeve studimore ose të lëndëve mësimore në gjuhë të huaja,
- Mungesë strategjie për tërheqjen e studentëve të jashtëm;
- Qasje joadekuate për krijimin e partnerëve strategjik perëndimorë;
- Promovim i pamjaftueshëm dhe qasje joadekuate për hartim dhe aplikim në projekte të ndryshme lokale dhe ndërkombëtare;
- Mungesë infrastrukture dhe përdorim joadekuat i infrastrukturës ekzistuese për veprimtari shkencore hulumtuese/artistike;
- Trajnime të pamjaftueshme për stafin mësimdhënës dhe atë administrativ.

### Mundësitë (Opportunities) për UP-në

- Marrëveshje anëtarësimi në ndonjë Aleancë të Universiteteve nga vendet e EU-së;
- Rritja e ofertës për shërbime për institucionet qeverisëse vendore;
- Lidhja dhe zbatimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me ekonominë (punë praktike, punë shkencore hulumtuese të përbashkët, zhvillimi i temave master, e posaçërisht ato të PhD në partneritet UP - biznese);
- Funkcionalizimi i instituteve dhe gjenerimi i fondeve për UP-në,
- Tërheqja e studentëve nga regjioni dhe me gjerë;
- Promovimi ndërkombëtar i programeve studimore në gjuhë të huaja;
- Aplikimi i përbashkët me universitetet perëndimore për projekte që financohen nga EU (HORIZON, ERASMUS +, etj.) dhe vendet e tjera të zhvilluara;
- Zhvillimi i programeve studimore me sistemin e diplomave të dyfishta, e më vonë edhe me diploma të përbashkëta;
- Promovimi i mobilitetit akademik përmes programeve të financuara nga EU (ERASMUS+, marrëveshje bilaterale me universitetet partnere).

### Rreziqet (Threats)

- Ikja e të rinjve dhe mungesa e promovimit për mundësitë në tregun e punës në Republikën e Kosovës;
- Vonesë në rishikimin dhe aprovimin e Statutit (për shkaqe procedurale);
- Rënia e interesimit për të studiuar në UP për shkak të jostabilitetit të menaxhmentit;
- Paga jo tërheqëse për punësimin e stafit të ri;
- Hezitim i personelit akademik për ndryshime përmbajtjesore të kurrikules;
- Mungesë mbështetjeje nga palët me interes.

## **3. Fushat e punës për mandatin menaxhues**

Duke analizuar detalet e prezantuara në SWOT, si dhe duke marrë parasysh dokumentet strategjike të UP-së<sup>2</sup>, programi i punës mund të përmblihet në fushat e punës për mandatin menaxhues:

1. Programet studimore;
2. Mësimdhënia dhe studentët;
3. Modelet e financimit;
4. Sigurimi i cilësisë;
5. Veprimtaria kërkimore/shkencore dhe infrastruktura;
6. Ndërkombëtarizimi;
7. Bashkëpunimi me ekonomi dhe shoqëri - Misioni i Tretë;
8. Menaxhimi dhe koordinimi;

---

<sup>2</sup> <https://uni-pr.edu/page.aspx?id=1,49>, Plani Strategjik i UP-së 2023-2025

### 3.1. Programet studimore

Që nga viti akademik 2001/2002, kur edhe fillon periudha e zbatimit të Procesit të Bolonjës në Kosovë, UP-ja ka qenë përfituese e shumë projekteve të ndryshme që në fokus kanë pasur modernizimin e kurrikulave. Janë realizuar shumë vizita studimore për të marrë përvoja nga praktikat e mira të universiteteve të zhvilluara perëndimore. Janë mbajtur shumë konferenca, seminare, punëtori e trajnime të ndryshme për të avancuar njohuritë rreth hartimit, akreditimit/riakreditimit të programeve studimore.

Vërejtje të shumta për të diplomuarit janë dhënë në fushën e mungesës së shkathtësive gjenerike. Në këtë drejtim, një raport i publikuar nga Agjencia e Akreditimit të Kosovës<sup>3</sup>, renditen dhjetë shkathtësitë kryesore që punëdhënësit i renditin si të rëndësishme për të punësuar punëtorët e rinj në arsim të lartë:

1. Aftësi për punë ekipore;
2. Aftësitë e komunikimit;
3. Aftësitë analitike dhe të zgjidhjes së problemeve;
4. Aftësia për t'u përshtatur dhe për të vepruar në situata të reja;
5. Aftësitë e të menduarit kritik;
6. Njohuri të gjuhëve të huaja;
7. Aftësi kompjuterike;
8. Shërbimi ndaj klientit;
9. Aftësia për të gjeneruar alternativa dhe ide novatore;
10. Aftësitë specifike të sektorit.

Vlen të theksohet se kohëve të fundit, Universiteti i Prishtinës (UP) po përballet me një problem krejtësisht të panevojshëm dhe të paarsyeshëm. Ka pasur raste kur programet e studimit në të gjitha nivelet kanë dështuar në procesin e akreditimit. Pavarësisht përpjekjeve dhe shpenzimeve të konsiderueshme, askush nuk mban përgjegjësi. Për më tepër, është shqetësues fakti se me rastin e themelimit të UP-së, programet e studimit nëpër fakultete i kanë mbajtur kryesisht mësimdhënësit me gradë shkencore master. Shumë pak mësimdhënës kanë pasur gradat shkencore të doktorit të shkencave. Në të kundërt, sot, çdo njësi akademike ka staf të mjaftueshëm që kanë arritur gradat më të larta shkencore dhe akademike, të krahasueshme me kolegët e tyre në universitetet më të avancuara në BE dhe më gjerë, ndërsa procesi i akreditimit dështon. Kjo situatë është e papranueshme në kushtet aktuale.

Me rastin e përgatitjes së programeve për akreditim/riakreditim, nuk ka bashkëpunim të mjaftueshëm me përfaqësuesit nga ekonomia. Nuk bëhen hulumtime të mjaftueshme për të analizuar trendin e kërkesave që bizneset dhe institucionet e tjera i kanë për të diplomuarit.

Ekziston edhe ngurrimi i stafit për zbatimin e reformave thelbësore, veçanërisht mosinteresimi për të zhvilluar dhe mbështetur programet që duhen ofruar në gjuhën angleze. Gjithashtu, duhet pasur parasysh se numri i studentëve ka rënë ndjeshëm në kohët e fundit, ndërkohë që i gjithë programi i studimit, pa ndonjë ndryshim të theksuar, vazhdon të riakreditohet dhe mbahet për disa studentë, pothuajse më shumë profesorë sesa studentë në program.

---

<sup>3</sup> Thematic Analysis; Preparation of the Kosovar Graduates for the Labor market – Employer and Alumni Perspective, <https://drive.google.com/file/d/11KykenlcT5y0lJmvQjyEbP26xGQYPbuP/view>

Referuar të dhënave të prezantuara në Tabelën 1, deri më 30 shtator 2024, UP-ja ka të akredituara 141 programe studimi në të gjitha nivelet, me tendencë që disa programe do të mbylljen pasi nuk do t'u vazhdohet akreditimi nga Agjencia e Akreditimit të Kosovës. Ajo që vërehet në tabelë dhe që duket shqetësuese është mbyllja e programeve në nivelin e studimeve të doktoratës. Kështu, derisa në vitin 2019, UP-ja i kishte të akredituara 19 programe studimi në nivelin e PhD, në vitin 2024, ky numër ka rënë në vetëm 5 të tilla. Gjithashtu, duke u nisur nga situata e brendshme që secili prej mësimdhënësve e di, por që nuk e shprehin, pyetja shtrohet: a ka nevojë që të gjitha këto programe studimi të vazhdojnë të ofrohen edhe më tej?

Duke larguar frikën e humbjes së vendeve të punës dhe me një angazhim dhe bashkëpunim të të gjitha palëve me interes, duke përfshirë stafin mësimdhënës, studentët, përfaqësuesit e ekonomisë, MASHTI, etj., duhet zbatuar një reformë të thelluar të programeve të studimit. Kërkohen veprime konkrete që programet e studimit t'u përshtaten nevojave të tregut të punës, veçanërisht si përgjigje ndaj trendëve në zhvillim që i ka sjellë depërtimi i Inteligjencës Artificial (IA). Kërkohet integrim i lëndëve mësimore të specializuara në IA dhe promovim i theksuar i praktikave të punës në kurrikula. Universiteti i Prishtinës duhet patjetër t'i sigurojë studentët se do të pajisen me kompetenca adekuate sipas kërkesave të tregut të punës për epokën e digjitalizimit. UP-ja duhet t'u garantojë studentëve se pas kompletimit me sukses të studimeve, ata lehtë do të përfshihen në tregun e punës dhe do t'i plotësojnë standardet për kuadro që i kërkon Industria 4.0.<sup>4</sup>

*Tabela 1: Programet e akredituara në UP*

Universiteti I Prishtinës									
NR.	Njesia Akadematike	2019				2024			
		Total	BA	MA	PhD	Total	BA	MA	PhD
1	Fakultetin Filozofik	13	7	5	1	15	7	8	0
2	FSHMN	19	9	8	2	20	11	9	0
3	Fakultetin e Filologjisë	18	8	8	2	19	9	10	0
4	Fakultetin Juridik	12	1	6	5	9	1	8	0
5	Fakultetin Ekonomik	14	6	4	4	10	6	4	0
6	Fakultetin i Inxhinierisë së Ndërtimit*	9	4	5	0	8	4	4	0
7	FIEK	7	5	2	0	8	4	3	1
8	Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike	10	6	4	0	8	5	3	0
9	Fakultetin e Mjekësisë	11	5	1	5	9	4	2	3
10	Fakultetin e Arteve*	17	9	8	0	10	5	5	0
11	Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinës*	11	5	6	0	12	4	8	0
12	Fakultetin e Shkencave Sportive	3	1	2	0	4	1	3	0
13	Fakultetin e Edukimit	10	3	7	0	8	3	4	1
14	Fakulteti i Arkitekturës					3	1	2	0
Total programe në UP		154	69	66	19	143	65	73	5

Burimi: Zyra për Zhvillim Akademik e UP-së.

\*Të akredituara deri më 30 shtator 2024.

<sup>4</sup> Industria 4.0, respektivisht Revolucioni i Katërt Industrial përfaqëson një ndryshim thelbësor në mënyrën se si jetojmë, punojmë dhe lidhemi me njëri-tjetrin. Është një kapitull i ri në zhvillimin njerëzor, i mundësuar nga përparimet e jashtëzakonshme të teknologjisë në proporcion me ato të revolucioneve paraprake industriale; Revolucionit të parë, të dytë dhe të tretë.

<https://www.weforum.org/focus/fourth-industrial-revolution/#:~:text=The%20Fourth%20Industrial%20Revolution%20represents,second%20and%20third%20industrial%20revolutions.>



**Objektivi:** Programe akademike bashkëkohore sipas Procesit të Bolonjës dhe të krahasueshme me vendet e Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë

**Masat dhe aktivitetet:**

- Zbatohet reformë e thelluar e programeve të studimit, hartohen programe bashkëkohore sipas parimeve të Procesit të Bolonjës, ESG 2015<sup>5</sup>, të krahasueshme me universitetet perëndimore;
- Mbahen trajnime për stafin akademik për hartimin e programeve studimore;
- Përfshihen aktorët relevantë nga ekonomia dhe sektorët socialë në procesin e zhvillimit të programeve të reja të studimit;
- Realizohen hulumtime të tregut për përditësimin e programeve ekzistuese si dhe hartimin e programeve të reja;
- Analizohen detajisht nevojat e vazhdimit të programeve ekzistuese;
- Promovohet hartimi dhe akreditimi i programeve që do të ofrohen në gjuhën angleze në nivelin BA dhe MA, dhe futja e lëndëve që do të ligjërohen në gjuhë të huaja;
- NJA përcaktohen për universitetet/fakultet partnere strategjike nga vendet e EU-së dhe përafrohen programet studimore;
- Promovohet zhvillimi i programeve të doktoratës në bashkëpunim me institucione të njohura të arsimit të lartë nga vendet e zhvilluara perëndimore;
- Inkurajohet akreditimi i programeve të doktoratës në gjuhën angleze dhe promovohet bashkëligjërimi dhe bashkëmentorimi me institucionet partnere strategjike;
- Përfshirja e shkathtësive të buta "*soft skills*" dhe njohurive digjitale në kuadër të programeve studimore;
- Fuqizohet mobiliteti akademik në kuadër të programeve studimore.

### 3.2. Mësimdhënia dhe studentët

Objektivi kryesor i funksionimit dhe ekzistencës së universiteteve është ofrimi i shërbimeve për studentë, që përmes programeve të akredituara, përmes procesit të mësimdhënies të ofrohet dije dhe shkathtësi adekuate për punësim dhe avancim në karrierë. Avancimi i metodologjisë dhe teknologjisë së mësimdhënies garanton zbatim me sukses të programeve të akredituara, si dhe pajisje me kompetenca gjenerike dhe specifike të diplomuarve, për të qenë ta gatshëm për tu përfshirë në tregun e punës në Kosovë dhe më gjerë. Mësimdhënia e bazuar me studentin në qendër<sup>6</sup> ofron mundësi për studentët që krahas shkathtësive specifike t'i zhvillojnë edhe shkathtësitë gjenerike, respektivisht njohuri për të komunikuar në gjuhë të huaja, për punë ekipore, shkathtësi prezantimi, etj.

UP-ja, me traditën më të gjatë të funksionimit në Kosovë dhe me numrin më të madh të stafit akademik, posedon potencial të mjaftueshëm për promovimin e programeve studimore në gjuhë angleze. Gjithashtu, një numër i stafit akademik ka përvoja të mira të bashkëpunimit me universitetet perëndimore. Stafi akademik i UP-së posedon shkathtësi

---

<sup>5</sup> European Standard and Guideline for Quality Assurance 2015 (Udhëzuesi dhe Standardet Evropiane për Sigurimin e Cilësisë 2015)

<sup>6</sup> Student Centered Learning; An Insight Into Theory And Practice <https://www.esu-online.org/ep-content/uploads/2016/07/2010-T4SCL-Stakeholders-Forum-Leuven-An-Insight-Into-Theory-And-Practice.pdf>

të mira në hartimin e projektpropozimeve, si dhe përvojë në veprimtarinë shkencore hulumtuese/artistike dhe në publikime në revista prestigjioze ndërkombëtare. Megjithatë, vërehet pamjaftueshmëri në mbështetje financiare për pjesëmarrje në konferenca, në seminare e në punëtori ndërkombëtare.

Kohëve të fundit, UP-ja është ballafaquar me probleme në procesin e përmbylljes me sukses të konkurseve për emërim, për riemërim ose për avancim të stafit akademik. Këto probleme burojnë si në kornizën ligjore të pa përkufizuar sa duhet, ashtu edhe nga mungesa e mbështetjes adekuate nga ana e UP-së për avancim në karrierë. Nuk bëhet vlerësimi adekuat i performancës së personelit mësimor të punësuar me vite e dekada, por hapen konkurse për të gjithë të interesuarit. Gjithashtu, në disa NJA vërehet angazhim i personelit mësimor në shumë lëndë mësimore, me tendencë të angazhimit edhe me mbinormë (6+6 orë në semestër). Komisionet vlerësuese zakonisht janë kolegë, stafi akademik i brendshëm. Përfshirja në komisione vlerësuese e mësimdhënësve nga universitetet prestigjioze perëndimore do të eliminonte shumë probleme me të cilat UP-ja është ballafaquar kohëve të fundit. Ende ekziston kategoria e asistentëve mësimorë, që në shumicën e universiteteve perëndimore ka kohë që nuk janë më. Rolin e mbajtjes së ushtrimeve që sot e realizojnë asistentët, do të duhej ta ushtronin studentët e doktoratës.

Dukuri e dëmshme që është prezentë një kohë të gjatë në UP, është mungesa e mobilitetit të brendshëm akademik. Lëndët e njëjta mësimore, ligjërohen në disa NJA të UP-së nga ligjërues të ndryshëm. Kështu, në vend që të jetë prezentë mobiliteti akademik brenda UP-së, pranohen mësimdhënës pa ndonjë analizë të nevojave afatgjata për ato kuadro.

Kohëve të fundit ka një rënie të ndjeshme të numrit të studentëve të regjistruar në UP. Siç mund të shihet në tabelën e mëposhtme, vetëm në 5 vjetët e fundit numri i studentëve është ulur me mbi 10.000 studentë, që i shprehur në vlera relative është një tjetër shifër shqetësuese prej 29,76%.

*Tabela 2: Numri i studentëve në UP në vitet akademike 2019/2020 dhe 2023/2024*

NR.	Njesia Akademike	2019/2020				2023/2024			
		BA	MA	PhD	Total	BA	MA	PhD	Total
1	Fakultetin Filozofik	2114	548	11	<b>2673</b>	1433	488	8	<b>1929</b>
2	FSHMN	2236	227	25	<b>2488</b>	1552	238	16	<b>1806</b>
3	Fakultetin e Filologjisë	2102	621	96	<b>2819</b>	1722	451	25	<b>2198</b>
4	Fakultetin Juridik	3911	318	4	<b>4233</b>	2830	607	4	<b>3441</b>
5	Fakultetin Ekonomik	6041	1526	36	<b>7603</b>	3159	1017	11	<b>4187</b>
6	FIN	1220	217	0	<b>1437</b>	777	252	0	<b>1029</b>
7	FIEK	1683	122	0	<b>1805</b>	1464	162	12	<b>1638</b>
8	FIM	1023	222	0	<b>1245</b>	626	205	0	<b>831</b>
9	Fakultetin e Mjekësisë	3331	62	139	<b>3532</b>	2933	181	106	<b>3220</b>
10	Fakultetin e Arteve	614	128	0	<b>742</b>	573	232	0	<b>805</b>
11	FBV	1453	220	0	<b>1673</b>	739	220	0	<b>959</b>
12	FEFS	751	160	0	<b>911</b>	487	117	0	<b>604</b>
13	Fakultetin e Edukimit	2169	1637	21	<b>3827</b>	806	931	5	<b>1742</b>
14	Fakulteti e Arkitekturës	712	26	0	<b>738</b>	644	60	0	<b>704</b>
<b>Total</b>		<b>29360</b>	<b>6034</b>	<b>332</b>	<b>35726</b>	<b>19745</b>	<b>5161</b>	<b>187</b>	<b>25093</b>

Burimi: <https://app.powerbi.com/view?r=eyJrIjoiMWJlOGU1MzgtMTBiNC00ZWMI1ThkYWVtZmU1ZTRjYjNINzBlliwidCI6ImMwMzRjM2I0LWQwMmItNDM2MS04M2YwLTNiMWI5ZWE0MzcvYyIsImMiOiJh9&pageName=ReportSection>

Në anën tjetër, rinia e Kosovës ende e shohin UP-në si zgjedhje të parë për t'i vijuar studimet universitare. Mirëpo, promovimi i programeve studimore dhe ofertës së UP-së në shkolla të mesme është i pamjaftueshëm. Raste të shumta janë kur studentët angazhohen vetëm në lëndë mësimore të programit, dhe mungojnë trajnime për punë praktike. Realizimi i mobilitetit të studentëve, transferi i ECTS-ve është i vështirë si në kuadër të UP-së po ashtu edhe me rastin e pjesëmarrjes në projekte ndërkombëtare si ERASMUS+. Ka shumë pak promovim dhe angazhim për tërheqjen e studentëve nga regjioni dhe më gjerë.

### **Objektivi: Avancimi i mësimdhënies dhe mësimnxënies**

#### **Masat dhe aktivitetet:**

- Në bashkëpunim me KD, Senatin dhe NJA inicohet procedura për ndryshimin e kornizës rregullative që të bëhet vlerësimi i performancës së stafit akademik për avancim në karrierë;
- Në proces të rekrutimit dhe të avancimit promovohet emërimi i komisioneve vlerësuese nga universitetet e vendeve të zhvilluara perëndimore (Kroaci e më lartë në perëndim.),
- Mbështetje financiare për aktivitetet kërkimore-shkencore dhe artistike;
- Organizim i trajnimeve seminareve dhe pjesëmarrja në konferenca ndërkombëtare për metodologjitë e reja të mësimdhënies;
- Zhvillimi i planit për ripërtërije të stafit akademik;
- Promovim dhe mbështetje financiare për bashkëpunim ndërkombëtar në fushën e kërkimit shkencor, dhe pjesëmarrje në konferenca shkencore ndërkombëtare,
- Mbështetje financiare për stafin akademik që mbajnë ligjëratë në programet që ofrohen në gjuhë të huaja;
- Promovohet, në kuadër të programeve që ndjekin, angazhimi i studentëve të doktoratës në ofrimin e pjesës praktike/laboratorike për studentë;
- Zhvillimi i strategjisë për të tërhequr studentë vendorë dhe ndërkombëtarë;
- Aplikohet mobiliteti i brendshëm akademik, e po ashtu promovohet dhe përkrahët mobiliteti akademik ndërkombëtar;
- Lehtësim i procedurave të transferit të ECTS-ve;
- Organizim i trajnimeve për shkathtësitë e buta për studentë:
  - Zhvillimi i karrierës;
  - Shkrimi akademik dhe i planeve të biznesit;
  - Përgatitja e CV-së dhe intervista për punë;
  - Negocimi në biznes;
  - Hartimi i projektpropozimeve dhe menaxhimi i tyre etj.

### **3.3. Modelet e financimit**

Përkundër mundësive që ofron Statuti, Universiteti i Prishtinës karakterizohet me një centralizim të theksuar të menaxhimit financiar. Nga ana tjetër, UP, pothuajse në tërësi financohet nga fondet publike, respektivisht nga buxheti i Kosovës. Ky model i financimit është tejkualuar në universitetet e zhvilluara perëndimore. Financimi bashkëkohor i universiteteve realizohet nga tri burime kryesore, që kanë rëndësi përafërsisht të njëjtë:

- Buxheti shtetëror;
- Të hyrat që realizohen përmes bashkëpunimit me ekonominë, përmes shërbimeve për institucionet shtetërore, përmes projekteve dhe granteve ndërkombëtare, etj., dhe
- Tarifat e pagesave të studentëve, me theks të veçantë për programet dhe trajnimet profesionale.

Një formë e tillë e financimit është munduar të promovohet edhe në UP përmes projektit TEMPUS FAITH<sup>7</sup>. Ekzistojnë ndërvarësi midis qëllimeve strategjike të politikës së qeveritare dhe sistemit të financimit në AL. Universitetet bashkëkohore kanë nevojë për fleksibilitet, si dhe aftësi për t'iu përgjigjur shpejtë kushteve në ndryshim të tregut.

Menaxhimi efikas financiar i universiteteve bashkëkohore kërkon ngritjen nivelit të përgjegjësisë dhe llogaridhënies financiare. Shpesh hasen qëndrime të ndryshme se gjoja të hyrat që realizohen nga stafi akademik dhe administrativ në universitetet publike nuk mund të publikohen derisa kërkohet ndryshim i qëndrimit dhe të kuptohet se të hyrat që realizohen në universitet janë para publike. Transparenca është një nga parimet shumë të rëndësishme. Universitetet publike në vendet e zhvilluara e kanë obligim ligjor publikimin në detaje të të hyrave që secili i punësuar i realizon<sup>8</sup>. Në UP është prezent centralizimi i theksuar i menaxhimit financiar, dhe si rrjedhojë kur nuk ka përgjegjësi të deleguara (nëpër njësi akademike) nuk mund të kërkohet as llogaridhënie.

Për të iniciuar përmirësimin e situatës, projekti TEMPUS ka zhvilluar të ashtuquajturin “dokumentin e bardhë”<sup>9</sup>, i cili ka përkufizuar disa nga problemet që do të ishte dashur të eliminohen, si:

- Mungesë përshkrimi të vendeve të punës, përcaktimi i kriterëve për ngarkesën e një stafi akademik/administrativ jo i përkufizuar qartë;
- Mungesa e përcaktimit të qartë të detyrave për stafin akademik;
- Kriteret të papërcaktuara në lidhje me mobilitetin akademik, kërkimin shkencor për stafin dhe studentët;
- Mungesë vlerësimi të performancës;
- Nevojë për rishikim të kornizës ligjore.

Në kuadër të projektit, janë realizuar edhe trajnime për modelet e reja të financimit si për nivelin menaxherial, ashtu edhe për administratë. Po ashtu janë zhvilluar module të softuerëve për të avancuar modelin e financimit në UP.

**Objektivi:** Promovim i modeleve të reja të financimit, menaxhim më efikas i financave, delegim i përgjegjësisë dhe llogaridhënie të NJA (te dekanët)

#### **Masat dhe aktivitetet:**

- Angazhimi në zhvillimin dhe zbatimin e modeleve të reja dhe moderne të financimit për institucionet e arsimit të lartë në Kosovë;
- Delegim i përgjegjësive për menaxhim financiar, dhe ngritje të nivelit të llogaridhënies të NJA;
- Aktivizimi i moduleve softuer të zhvilluara përmes projektit FAITH, si dhe zhvillimi i moduleve të tjera të domosdoshme për menaxhim efikas financiar;
- Ngritja e transparencës për të hyrat që stafi akademik dhe administrativ i realizon në UP;
- Rishikimi i rregullores për të ardhura personale, realizimi i pagesave shtesë për personelin e angazhuar në veprimtari shkencore/artistike përmes projekteve;
- Përshkrimi i qartë i vendeve të punës si për stafin akademik, ashtu edhe për administratë.

<sup>7</sup> Tempus project FAITH: “Increasing the Financial Autonomy and Accountability at public higher education institutions in Kosova”, No- 544142.

<sup>8</sup> Arizona State University, <https://thestatepress.github.io/SalaryList/dist/index.html>

<sup>9</sup> Tempus project FAITH, no-544142, White Paper: “Financial Model for the Kosovo Public Higher Education System”

### 3.4. Sigurimi i cilësisë

Sigurimi i cilësisë është një nga indikatorët bazë për famën e universiteteve, rangimin e tyre, gjenerimin e fondeve përmes projekteve, tërheqjen e studentëve, si dhe shkallën e punësimshmërisë së të diplomuarve. Në kohën e ekonomisë dhe të shoqërisë së bazuar në dije, universitetet janë shndërruar në faktorë kryesorë zhvillimorë. Një nga parimet bazë sipas ESG 2015 është se sigurimi i cilësisë duhet të marrë parasysh nevojat dhe pritshmëritë e studentëve, të palëve të interesuara dhe të shoqërisë.<sup>10</sup> Së këndejmi, sigurimi i cilësisë për UP-në, është jo vetëm interes për avancimin institucional, por edhe mision dhe obligim për mbështetjen e zhvillimit socio-ekonomik të Republikës së Kosovës.

UP-ja ka përfituar një numër të konsiderueshëm të projekteve TEMPUS dhe ERASMUS+ që si temë kanë pasur sigurimin e cilësisë (më shumë detaje në Aneks: të dhëna bazë të CV-së dhe disa prej projekteve të zbatuara). Në kuadër të projektit TEMPUS EUREQA<sup>11</sup>, ku grantmbajtës ka qenë Asociacioni Universiteteve të Evropës, ndërsa UP-ja pjesë, janë realizuar disa analiza dhe publikime, ku spikatet rëndësia e obligimi ligjor që kanë universitetet për sigurimin e cilësisë.

Referuar dokumenteve zyrtare të UP-së për sigurimin e cilësisë<sup>12</sup>, si dhe dokumenteve të tjera relevante ndërkombëtare, sigurimi i cilësisë është përgjegjësi e secilit që është i angazhuar në UP, duke filluar nga menaxhmenti, personeli mësimor, studentët dhe administrata. UP-ja në këtë fushë ende ballafaqohet me disa probleme që do të duhej të ishin tejkaluar shumë kohë më parë. Ka raste kur programet në nivelin BA dhe MA nuk akreditohen nga Agjencia e Akreditimit të Kosovës. Studimet e PhD-së janë të rrezikuara. Janë mbyllur disa programe të PhD-së edhe në NJA që kanë pasur traditë akreditimi dhe staf akademik të mjaftueshëm për ofrimin e këtij niveli të studimeve. Në të shumtën e rasteve, fajtorin e gjejmë jashtë UP-së. Një publikim rishtas i realizuar nga Agjencia e Akreditimit të Kosovës<sup>13</sup>, që ka të bëjë me akreditimin institucional të IAL-ve, ka rezultuar në atë që në të shumtën e rasteve gabimet kanë qenë të institucioneve që kanë aplikuar. Shpesh gabimet e njëjta janë përsëritur në shumë institucione. Si duket ende ka nevojë për trajnime shtesë për hartimin e programeve studimore për akreditim/riakreditim dhe për përcjelljen e sigurimit të cilësisë në fazën pas akreditimit<sup>14</sup>.

Studimet e doktoratës janë të izoluara dhe të koncentruara kryesisht në kuadër të UP-së. Në kohën kur fondet për mobilitetet akademik përmes programeve dhe projekteve të ndryshme ndërkombëtare si ERASMUS+, etj., po shtohen gjithnjë e më shumë, studentët e doktoratës nuk janë të obliguar, e as të interesuar që të jenë pjesë e këtyre mobiliteteve. Në të shumtën e rasteve ata i përfundojnë studimet e doktoratës pa kryer asnjë semestër, apo pa vizituar asnjë universitet në vendet e zhvilluara perëndimore.

<sup>10</sup> ESG 2015, [https://www.enqa.eu/wp-content/uploads/2015/11/ESG\\_2015.pdf](https://www.enqa.eu/wp-content/uploads/2015/11/ESG_2015.pdf)

<sup>11</sup> Çastet EUREQA! Marifetet kulmore të sigurimit të cilësisë së brendshme dhe ekzaminimi i kulturës së cilësisë, Projekti TEMPUS: Empowering Universities to fulfill their responsibility for Quality Assurance no. 530631 (EUREQA)

<sup>12</sup> <https://www.uni-pr.edu/page.aspx?id=1,73>

<sup>13</sup> Thematic Analysis for Institutional Accreditation of Kosovar Higher Education Institutions, <https://drive.google.com/file/d/111WCL4KhYg23gkE0VQSKN4QlGxUp9Tmb/view>

<sup>14</sup> Report on Situation Analysis of National Qualification Authority and Kosova Accreditation Agency for monitoring of the post-accreditation process, projekti ALLED 2



**Objektivi:** Avancimi i sistemit për sigurimin e cilësisë në mësimdhënie dhe veprimtari shkencore/artistike

**Masat dhe aktivitetet:**

- Për nevoja të brendshme, NJA-të bëjnë hulumtimin e nevojave të tregut të punës;
- Trajnime të rregullta vjetore për zhvillimin dhe akreditimin/riakreditimin e programeve akademike dhe profesionale;
- Zhvillimi i programeve për akreditim/riakreditim sipas nevojave të tregut të punës;
- Përafrimi i programeve studimore me universitetet partnere strategjike perëndimore;
- Zhvillimi dhe akreditimi/riakreditimi i programeve të doktoratës në gjuhën angleze dhe në partneritet me ekonominë;
- Zbatimi i metodës së bashkëligjërimit dhe bashkëmentorimit me universitetet partnere strategjike perëndimore;
- Hartohen dhe publikohen në faqetueb të NJA-ve, doracakët për programet studimore që ofrohen;
- Në nivel të NJA-ve formohen komisionet e fushave për monitorimin dhe për vlerësimin e ligjëratave, së paku një ligjëratë e monitoruar brenda vitit akademik;
- Ofrohen trajnime të rregullta për publikime shkencore hulumtuese;
- Mbështetje e shtuar financiare për pjesëmarrje të stafit mësimdhënës në konferencat shkencore ndërkombëtare;
- Avancohet sistemi për parandalimin e plagjiaturës;
- Promovohet mobiliteti akademik për stafin mësimdhënës dhe studentët përmes projekteve ndërkombëtare (ERASMUS +);
- Obligohen studentët e doktoratës që së paku një vit akademik të qëndrojnë në ndonjë universitet të zhvilluar perëndimor (Kroaci e më lartë/perëndim)
- Organizohen trajnime të rregullta për studentë për shkathtësitë e buta (*soft skills*);
- Promovim dhe mbështetje e stafit mësimdhënës për zhvillimin e projektpropozimeve, dhe ftesa për mësimdhënës vizitorë për kohë më të gjatë qëndrimi (Fulbright visiting professors).
- Popullimi dhe përditësimi rregullt i faqesueb me informata të reja në shqip e edhe në anglisht;
- Publikimi i informatave për të gjitha mbledhjet e rregullta të organeve të NJA-ve dhe të UP-së, si dhe orari i provimeve për tërë vitin akademik.

### 3.5. Veprimtaria kërkimore shkencore/artistike dhe infrastruktura

Përkundër faktit se UP-ja është institucioni me i vjetër i AL dhe ka një traditë në veprimtarinë kërkimore shkencore/artistike, është ende larg parametrave të universiteteve të zhvilluara perëndimore. Kjo është edhe rezultat i gjendjes së përgjithshme të investimeve që bëhen në këtë fushë në Kosovë. Në bazë të hulumtimeve<sup>15</sup> dhe të raporteve të shumta, Kosova është shumë larg edhe vendeve të rajonit për sa i përket pjesëmarrjes së shpenzimeve për hulumtim dhe zhvillim (R&D) në GDP-në e Kosovës. Por, kjo nuk do të thotë se nuk mund të bëhen përmirësime në këtë drejtim. Kontratat e punës të stafit

<sup>15</sup> Knowledge-Based Society: R&D Investments in New Economic Transformation, Luljeta Aliu Mulaj and But Dedaj, "Springer Nature Singapore, Accounting, Finance, Sustainability, Governance & Fraud: Theory and Application; New Approaches to CSR, Sustainability and Accountability, Volume IV, ISBN 978-981-16-9498-1 ISBN 978-981-16-9499-8 (eBook), 10.1007/978-981-16-9499-8.

akademikë nuk përcaktojnë obligimin për veprimtari shkencore hulumtuese/artistike. Institutet nëpër NJA ose janë vetëm në letër, ose funksionojnë me vështirësi. Rregullorja për funksionimin e instituteve nëpër njësi akademike vështirëson zbatimin e projekteve. Ka pasur raste kur edhe janë fituar projektet, dhe ka filluar faza përgatitore, nuk kanë mundur të realizohen shpenzimet përmes instituteve, duke qenë të detyruar për të hequr dorë nga projekti. Stafit akademik nuk mbështetet për të zhvilluar projektpropozimet. Ka pasur raste kur është fituar projekti, dhe pastaj me vendim të menaxhmentit i është bartur dikujt tjetër për ta zbatuar. Realizimi i aplikacionit me sukses pozitiv në ftesa të ndryshme për aplikim, që financohen nga fondet lokale dhe ndërkombëtare nuk çmohet. Ka mungesë të trajnimeve për zhvillimin e projektpropozimeve ndërsa mbështetja financiare për punë shkencore kërkimore/artistike është e pamjaftueshme. Infrastruktura për veprimtari kërkimore shkencore/artistike kërkon investime për pajisje të reja, por edhe ato ekzistuese (të shpërndara nëpër NJA-të) nuk përdoren me efikasitet.

Me gjithë vështirësitë e shumta, UP-ja ka realizuar përpjekje të kufizuara për promovimin e kësaj fushe. Kështu, me ndihmën e partnerëve ndërkombëtarë, në vitin 2012 përmes projektit TEMPUS<sup>16</sup>, është hartuar Strategjia për veprimtari kërkimore shkencore/artistike dhe zhvillimore 2013-2016. Këtij dokumenti mjaft përmbajtjesor, i kanë munguar mekanizmat e zbatimit në praktikë. Për të përmirësuar situatën duhet angazhim i nivelit qendror të menaxhmentit, të NJA-ve, dhe të tërë stafit akademikë që puna në këtë fushë të promovohet dhe të mbështetet në realitet.

Në këtë drejtim, është arritur progres me miratimin e Rregullores me numër protokollit 1/175, të datës 18.04.2024, për Financimin e Veprimtarive Kërkimore - Shkencore, Artistike dhe Sportive në Universitetin e Prishtinës. Prapëseprapë, mbetet shumë punë për të bërë që kjo fushë prioritare të marrë respektin e duhur në UP.

**Objektivi:** Avancimi i veprimtarisë kërkimore shkencore/artistike dhe përmirësimi i infrastrukturës

**Masat dhe aktivitetet:**

- Përditësohet Strategjia për veprimtari shkencore kërkimore/artistike për periudhë 5 vjeçare;
- Hartohet modeli i ri i kontratave të punës dhe bëhet përcaktimi i obligimeve për kontribut në veprimtarinë kërkimore-shkencore/artistike për personelin akademik;
- Stimulim material për studentëve të doktoratës të angazhuar në mësimdhënie dhe në projekte shkencore kërkimore/artistike;
- Zhvillohen kriteret për stimulim material të stafit të përfshirë në punën kërkimore-shkencore/artistike;
- Nxitet bashkëpunimi i stafit akademik nga UP-ja me ekspertë nga diaspora për realizimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore/artistike dhe zhvillimore;
- Funksionalizimi dhe avancimi i infrastrukturës për punë kërkimore-shkencore/artistike dhe për ofrimin e shërbimeve;
- Lidhen marrëveshje për shfrytëzim të infrastrukturës kërkimore të institucioneve të tjera në vend dhe me universitetet partnere strategjike;
- Themelohen/funksionalizohen laboratorë dhe institute, si dhe pajisen me infrastrukturë përkatëse;
- Organizohen trajnime dhe ofrohet asistencë teknike për hartimin e projekteve;

---

<sup>16</sup> Tempus project finance by the EC: Creating R&D Capacities and Instruments for boosting Higher Education-Economy Cooperation, Project number: 145180.

- Stimulim material për realizimin me sukses të aplikimeve për projekte të ndryshme lokale dhe ndërkombëtare;
- Stimulim material për stafin akademikë që ka hartuar projekt propozime.

### 3.6. Ndërkombëtarizimi

Ndërkombëtarizimi kontribuon në mundësinë e krahasimit të tërë procesit mësimor dhe të veprimtarisë kërkimore shkencore/artistike me të universiteteve të zhvilluara perëndimore. Në këtë drejtim, ndërkombëtarizimi në vete përfshinë edhe aktivitete që i kontribuojnë ngritjes së cilësisë.

